



EVN është një kompani aktiviteti kryesor i së cilës është distribuimi, furnizimi dhe prodhimi i energjisë elektrike. Kompania është prezente në tregun e maqedonisë as që nga viti 2006 si pjesë e grupacionit EVN. Në 15 vitet e fundit në këtë treg, EVN përpiqet të ruajë profesionalizëm të lartë dhe cilësi të vazhdueshme të shërbimeve për klientët e saj.

KARRIERË NË EVN

Për nevojat e Departamentit të Auditimit të Brendshëm, kërkojmë specialist/e që do të luajë një rol kyç në realizimin e projekteve tona.

AUDITOR (M/F)

Detyrat dhe aktivitetet:

- Analiza dhe vlerësimi i proceseve operationale, menaxheriale dhe financiare në kompani, duke kontrolluar përputhshmërinë me rregulloret ligjore dhe rregulloret nga organet e tjera kompetente si dhe udhëzimet e dhëna nga grupacioni apo shoqëria.
- Përgatitja e propozimeve për përmirësimin e situatës bazuar në rezultatet e kontrolleve
- Kontrolli i heqjes së mangësive
- Pjesëmarrja në ofrimin e mbështetjes për Bordin Menaxhues në përmbushjen dhe përmirësimin e funksioneve të kontrollit
- Pjesëmarrja në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (plotësia, ekonomia dhe përshtatshmëria) dhe këshillimi i menaxhmentit
- Vlerësimi i rreziqeve, raportimi i rreziqeve të identifikuara dhe dhënia e udhëzimeve për tejkalimin e tyre
- Pjesëmarrja në përgatitjen e planit vjetor të auditimit

Kualifikimet e kërkuara

- Arsimi i lartë – Fakulteti Ekonomik (ose fusha të ngjashme)
- Të paktën 3 vite përvojë pune në këtë fushë
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe MS Office
- Njohja e softuerit për punimin e të dhënave do të konsiderohet përparësi
- Arsyetimi logjik
- Aftësia për të përcaktuar prioritetet
- Aftësi për të punuar në të njëjtën kohë për çështje të ndryshme
- Dëshirë për të mësuar vazhdimisht gjëra të reja
- Aftësia për arsyetim induktiv dhe deduktiv
- Vetëorganizimi dhe ndjenja e përgjegjësisë

Nëse jeni të interesuar për karrierë në EVN, dërgoni biografinë tuaj të shkurtër në jobs@evn.mk më së voni deri më **22.07.2022**.

Shënim: Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke paraqitur aplikacionin tuaj, ju pranoi që të dhënat tuaja të ruhen, përpunohen dhe përdoren ekskluzivisht për qëllime rekrutimi dhe përzgjedhjeje. Më shumë informacion për të drejtat tuaja për përpunimin e të dhënave, si dhe për mënyrën e përpunimit të të dhënave mund të gjeni në linkun e mëposhtëm <https://www.evn.mk/Careers.aspx>.

EVN Maqedoni është një kompani që ofron mundësi barabarta dhe tretman të drejtë gjatë punësimit të të gjithë personave pavarësisht racës, gjinisë, religjionit, përkatesisë nacionale, llojit të aftësisë së kufizuar ose përkatesisë politike.